



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: **17.09.2025**

Nr. **5-3080**

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesës nr. 5-3080 të datës 12.08.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, nxjerr:

V E N D I M

Për licencimi dhe rilicencimin e Kolegjit të shkencave mjekësore “Rezonanca”

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet në nivel institucional për periudhën (5) pesëvjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030).
2. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (5) pesëvjeçare (1 tetor 2022-30 shtator 2027) për programin e studimit:
 - 2.1. Radiologji diagnostike BSc. 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.
3. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (3) trevjeçare 2022-2025 (1 tetor 2022 - 30 shtator 2025), programet e studimit:
 - 3.1. Biokimi laboratorike BSc. 180 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - 3.2. Farmaci MSc. 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.
4. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (3) trevjeçare 2024-2027 (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027), për programin e studimit:
 - 4.1. Infermieri BSc. 180 ECTS me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.
5. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, licencohet për periudhën (3) trevjeçare 2024-2027 (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027), programet e studimit:
 - 5.1. Fizioterapi dhe Mjekësi sportive, MSc. 120 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;

- 5.2. Fizioterapi BSc. 240 ECTS me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.
6. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (3) trevjeçare 2023-2026 (1 tetor 2023- 30 shtator 2026), programin e studimit:
- 6.1. Farmaci komunitare BSc. 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik.
7. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, licencohet për periudhën (3) trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), programet e studimit:
- 7.1. Menaxhim i kujdesit shëndetësor dhe ekonomi shëndetësore MSc. 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.
8. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (3) vjeçare 2025-2028(1 tetor 2025- 30 shtator 2028), me programin e studimit:
- 8.1. Biokimia laboratorike BSc. 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.
9. Bartësi privat i arsimit të lartë, kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca”, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.
10. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. 5-3080 të datës 12.08.2025 të parashtruar nga BPrAL- kolegji i shkencave mjekësore “Rezonanca” dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim si në vijim: vendimi me nr. ref. 327/24 i dt. 02.04.2025, vendimi nr. ref. 928/22 i dt. 15.07.2022, vendimi nr. ref. 1392/24 i dt. 12.07.2024, vendimi nr. ref. 845/25 i dt. 10.07.2025, vendimi nr. ref. 583/25 i dt. 27.05.2025 dhe vendimit me nr. ref. 1014/23 të dt. 26.07.2023, komisioni vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit “Rezonanca”;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

